

Bullizmi në shkollë

Bullizëm konsiderohet ajo dukuri ku një/disa individë përdorin lëndimin si mënyrë për të dëmtuar vetëvlerësimin e viktimës. Të kuptosh se cilët janë këta individë dhe pse i zgjedhin viktimat e tyre, mund të jetë hapi i parë në parandalimin e këtyre sjelljeve. Bullizmi në shkollë i referohet gjithë llojeve të bullizmit që ndodhin në ambientet e shkollës; ndërmjet moshatarëve, nga më të rriturit tek më të vegjëlit, nga apo kundrejt mësuesve.

Një person përfshihet në bullizëm kur ekspozohet vazhdimisht dhe për një periudhë kohe ndaj veprimeve negative, nga/ndaj një apo më shumë personave. Bullizmi është një dhunë e zgjatur, fizike apo psikologjike, nga një person apo grup personash, e drejtuar ndaj një personi cili nuk mund të mbrohet në atë situatë. Bullizmi është ajo situatë ku një person përdor forcën në mënyrë të qëllimshme, me synimin për të lënduar tjetrin në mënyrë të përsëritur; është dëshirë e ndërjegjshme për të lënduar dhe për të vendosur tjetrin nën stres.

Forma të bullizmit

Bullizmi mund të shfaqet në disa mënyra, por pesë prej tyre janë më të përhapura:

Bullizmi fizik. Përfshin të qëlluarin, shqelmat apo shkatërrimim e pronës së dikujt, ku një grup nxënësish sulmojnë një tjetër, por përgjithësisht ndodh që një nxënës më i madh, apo më i fortë dhunon një nxënës më të vogël. Bullizmi fizik nuk lidhet vetëm me dhunuesin e viktimën, por mund të ketë impakt edhe te dëshmitarët.

Bullizmi verbal. Përfshin ofendimet, talljet, të folurin racist ose si ngacmim seksual. Po ashtu, këtu përfshihet edhe kërcënimi. Viktimat e këtij lloji bullizmi mund të mos reagojnë menjëherë, por me kalimin e kohës mund ta vuajnë këtë gjë.

Bullizmi i maskuar. Zakonisht ndodh pas shpinës së viktimës dhe synon dëmtimin e reputacionit të viktimës. Gjithashtu, përfshin tregimin e historive të pakëndshme, mimikë tallëse dhe shaka të pavenda me viktimën, etj. Kjo formë është një nga format më të përdorura të bullizmit, dhe për shkak se të rriturit mund të mos kenë dijeni për ekzistencën e tij, është edhe më i vështiri për t'u kontrolluar e ndaluar.

Bullizmi elektronik. Mund të ndodhë kudo dhe në çdo kohë, falë zhvillimit të teknologjisë në shkollë dhe në shtëpi. Ky lloj bullizmi ndodh nëpërmjet mesazheve të shkruara apo në internet, dhe është shumë i vështirë të kontrollohet. Ata që ushtrojnë dhunë “të fortët”, zakonisht janë viktima të bullizmit në jetën reale dhe e drejtojnë frustrimin e tyre kundrejt viktimave, duke e fshehur privatësinë pas kompjuterit apo telefonit. Sjellja e tyre përfshin depersonalizimin e viktimës online, duke mundësuar që të tjerët të krijojnë një përshtypje negative për ta, të përhapin thashetheme, etj.

Përrjashtimi. Ndodh kur “të fortët” nxisin shokët apo moshatarët e viktimës që ta përjashtojnë viktimën gjatë një loje apo aktiviteti të organizuar. Duke u përjashtuar në këtë mënyrë, viktima do ta ketë të vështirë të krijojë marrëdhënie dhe mund të vuajë izolimin në të ardhmen. Mund të ndodhë edhe që “të fortët” të kërcënojnë të ngjashmit e viktimës, që nëse nuk e përjashtojnë, do të kenë edhe ata një fat të tillë.

Çfarë karakteristikash kanë “të fortët”?

- Kanë besim të fortë në vete, janë impulsiv dhe agresiv.

- Kanë inteligjencë verbale dhe arritje shkollore të ulëta.
- Përgjithësisht janë pak më të rritur se viktimat.
- Nuk janë empatikë.
- Përdorin bullizmin për fuqi dhe kontroll.
- Përdorin dhunën për zgjidhjen e konfliktit.
- Kanë vetëvlerësim të ulët dhe e shikojnë dhunën si një forcë pozitive.
- Mund të mos kenë angazhimin e prindërve në shtëpi, dhe kanë pikëpamje negative lidhur me bashkëmosharët dhe mjedisin e shkollës.
- Janë lehtësisht të frustrueshëm, ankthiozë dhe kanë një kohështrirje të shkurtër të përqendrimit. Këta fëmijë mund të bëhen “të fortë”, pasi e shijojnë fuqinë që prodhojnë kur mërzhisin të tjerët.
- Nuk ndjejnë empati për viktimën dhe mund të ndihen të justifikuar për sjelljen e tyre.

Çfarë karakteristikash kanë “viktimat”?

- Viktimat nuk zgjidhen në mënyrë rastësore.
- Përgjithësisht janë individë ankthiozë, të pasigurtë dhe u mungojnë aftësitë sociale.
- Zakonisht janë vetmitarë apo të izoluar nga grupi.
- Mund të jenë të vegjël apo fizikisht të dobët.
- Qajnë lehtësisht dhe janë jopranues.
- Mund të kenë probleme të të mësuarit ose fizike.